



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 1 Datë 24.01.2018

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE “**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të ujit” gërma c ; nenit 41, “Përdorimi me leje i ujit” gërmat a dhe d ; nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore “ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin - Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë :

V E N D O S I :

- 1- Të miratojë kërkesën e subjektit “**ERALDI & PSM**” shpk me administrator Z. Genc MARKU për përdorimin e burimit ujqor Shpati i Majës së Malit në fshatin Flet , Njësia Administrative Blerim, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, për ambalazhim të ujit në shishe dhe enë.
Koordinatat e veprës së marrjes: X -46 66 743; Y - 44 25 954; Z - +1115m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit: X -46 65 444; Y - 44 27 470; Z - + 795 m;
Prurja mesatare vjetore e burimit është 20 l/sek = 0.02 m³/sek.
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 1 l/sek = 0.001 m³/sek .
- 2- Leja e përdorimit të burimit ujqor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

